



Viti i VII-të i Botimit, Nr.2,  
Dhjetor 2016

## VLERËSIMI I MARRËDHËNIES SË PUNONJËSIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE ME HALLKAT E TJERA KRYESORE TË SISTEMIT TË REFERIMIT

Marinela (Zajmi) Çani (student doktorant)

Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: [marinelacani@yahoo.com](mailto:marinelacani@yahoo.com)

### Përmbledhje

Fëmija është ndër subjektet e së drejtës, të cilit shteti duhet t'i garantojë mbrojtjen e posaçme për shkak të moshës së mitur dhe brishtësisë në realizimin e të drejtave të tij. Interesi më i lartë i fëmijës është mekanizmi bazë me të cilin shoqëria jonë bën të mundur balancimin e veprimtarisë vendimmarrëse, qoftë kjo shtetërore, publike apo private.

Ky artikull pasqyron dhe analizon kontekstin ndërkombëtar dhe atë kombëtar të legjislacionit dhe instrumenteve që mbështesin mbrojtjen e fëmijëve, ngritjen e një sistemi funksional për arritjen e këtij qëllimi dhe ofrimin e shërbimeve të larmishme dhe cilësore, duke u udhëhequr nga interesi më i lartë i fëmijës.

Rishikimi i detajuar i kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, përfshirë konventa, ligje, vendime, udhëzime, ndihmoi në identifikimin e arritjeve dhe boshllëqeve të kuadrit ligjor vendas.

Legjislacioni shqiptar, i cili ka në fokus mbrojtjen e fëmijëve, ka evoluar ndjeshëm duke krijuar një kuadër të plotë ligjor dhe institucional, i cili synon ngritjen, funksionimin dhe standardizimin e sistemit gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtat të tyre.

**Fjalë çelës:** *mbrojtje e fëmijëve, sistem i mbrojtjes së fëmijëve, ekip shumëdisiplinor, bashkëpunim.*

*THE RELATIONSHIP'S EVALUATION BETWEEN CHILD PROTECTION WORKERS IN  
COLLABORATION WITH OTHER KEYS OF REFERRAL SYSTEM. (LITERATURE REVIEW)*

### ABSTRACT

Child is one of the subjects of law, which the state must ensure special protection due to minors and vulnerability in the realization of his rights. The best interest of the child is the basic mechanism by which our society makes possible the balance of decision-making

activity whether it is state, public or private.

This article reflects and analyzes the international and national legislation context and instruments that support child protection, the establishment of a functional system for achieving this goal and providing diverse and quality services, being guided by the best interests of the child.

Detailed literature review of international and national legal framework, including conventions, laws, decisions, instructions helped to identify achievements and gaps in the national legal framework.

Albanian legislation which focuses on child protection has evolved considerably by creating a complete and institutional legal framework aimed at establishment, operation and standardization of a comprehensive child protection system and promotion of their rights.

**Key words:** *child protection, child protection system, multidisciplinary team, cooperation.*

## HYRJE

Historia ka lindur nevojën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, qoftë në nivel ndërkombëtar, dhe në atë të kombëtar, nga të gjitha shtetet. Çdo hap që ndërmerret për mbrojtjen e fëmijës, udhëhiqet nga interesi më i lartë i tij. Kuadri ligjor merr një rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për të. Ofrimi i shërbimeve të sigurta, të plota dhe cilësore në mbrojtje e fëmijëve duhet të jetë prioritet i çdo shoqërie që synon mirëqenien e fëmijëve.

Qeveritë kanë përgjegjësi që të marrin të gjitha masat ekzistuese për të siguruar që të drejtat e fëmijëve të respektohen, mbrohen dhe përmbushen. Ato janë të detyruara të marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që të përmbushen standardet minimale të përcaktuara nga Konventa dhe duhet të ndihmojnë familjet që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe të krijojnë një mjedis ku ata të rriten dhe të arrijnë potencialin e tyre (1).

Fëmija është ndër subjektet e së drejtës, të cilit shteti duhet t'i garantojë mbrojtjen e posaçme për shkak të moshës së mitur dhe brishtësisë në realizimin e të drejtave të tij. Interesi më i lartë i fëmijës është mekanizmi bazë me të cilin shoqëria jonë bën të mundur balancimin e veprimtarisë vendimmarrëse, qoftë kjo shtetërore, publike apo private.

Sipas Carrie Auer, përfaqësuese e UNICEF-it në Shqipëri, mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve. Ndërsa kjo tradicionalisht është e lidhur me sistemin e mirëqenies sociale. Që një sistem mbrojtjeje të funksionojë, duhet që të gjithë sektorët që kanë lidhje me të, si: shëndetësia, arsimi, shërbimet sociale, policia dhe drejtësia, të luajnë rolin e tyre duke e koordinuar punën e tyre. Një bashkëpunim i tillë midis sektorëve nuk mund të bëhet në mënyrë rastësore, por duhet të institucionalizohet për të siguruar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë. Ngandonjëherë “përgjegjësia e të gjithëve” do të thotë “përgjegjësia e askujt”. Për t’iu kundërvënë kësaj tendence, del nevoja që urgjentisht, të përcaktohen personat përgjegjës në institucionet që merren me mbrojtjen e fëmijës dhe familjes, në secilin sektor, në nivelin lokal dhe qendror të qeverisjes. Gjithashtu, është e nevojshme që të përgatiten protokolle të qarta për përgjegjësitë dhe veprimet, me qëllim që njerëzit të jenë të qartë për detyrat e tyre dhe të dinë se ku duhen referuar rastet dhe me kë duhet ta koordinojnë punën (2).

Vlerësimi i marrëdhënies së punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me hallkat e tjera kryesore të sistemit të referimit

## INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE NË MBROJTJE TË FËMIJËVE

Fillesat e para të sigurimit të mbrojtjes së fëmijëve i gjejmë në **Deklaratën e Universale mbi të Drejtat e Njeriut**. Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut. Sipas kësaj deklarate, fëmijët, si kategori e veçantë, gëzojnë mbrojtje të veçantë. Duke u bazuar në statusin e ndjeshëm dhe jo shumë të fuqishëm që kanë fëmijët në shoqëri, Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut dhe Kombet e Bashkuara ritheksoan faktin se “mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë të familjes, si njësi themelore e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj, veçanërisht të fëmijëve. Ajo duhet të ketë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi, se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi. Kjo deklaratë ka si qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal të të drejtave.

Në nenin 25 të saj, ajo përcakton mbrojtjen e veçantë për fëmijët, barazinë dhe mosdiskriminimin e fëmijëve të lindur në martesë dhe jashtë martese, duke parashikuar se: “*Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale*” (3).

Ndërkohë, **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës** parashikon gëzimin e barabartë nga të dy bashkëshortët për fëmijët, si gjatë martesës, dhe pas zgjidhjes së saj. Duke vënë në pah një aspekt shumë të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijës, shtetet anëtare mund të ndërhyjnë në kufizimin e kësaj të drejte, pra të gëzimit të fëmijëve nga të dy bashkëshortët, në interesin më të lartë të fëmijëve (4).

Hapi i parë specifik, në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në fushën ndërkombëtare, është **Konventa për të Drejtat e Fëmijëve**. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989, ajo ka hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.

Kjo konventë është traktati i të drejtave të njeriut, më i ratifikuari në historinë e traktateve. Në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve citohet se “*fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, duke përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes*”.

Që në hyrje, Konventa për të drejtat e fëmijëve është angazhuar që t’i sigurojë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij. Në nenin 3 të saj thekson faktin se “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese*”. Konventa e përcakton një “fëmijë” si një person nën moshën 18 vjeçare. Ndërsa Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve është organi i përcaktuar si organi monitorues i Konventës. Kjo Konventë thekson se shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e tij, të drejtën për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik, mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë tjetër e shfrytëzimit që dëmton mirëqenien e tij në çfarëdo aspekti, marrjen e të gjitha masave të përshtatshme legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës, njohjen e të drejtës së çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Fryma e përgjithshme e Konventës është favorizuese ndaj familjes, duke e konsideruar atë me rëndësi thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Gjithashtu, kjo konventë thekson faktin se për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në të, shtetet palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura efektive për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që përkujdesen për të, si dhe parashikon forma të tjera parandalimi, identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më sipër, duke përfshirë, nëse duhen procedurat e ndërhyrjes gjyqësore (1).

**Konventa Evropiane mbi marrëdhëniet me fëmijët**, siguron mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të marrëdhënieve në të cilat përfshihet ai.

Kjo konventë ka si objekt të saj:

- a) përcaktimi i parimeve të përgjithshme për t'u zbatuar në lidhje me vendimet mbi marrëdhëniet;
- b) rregullimi i garancive të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies;
- c) vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

Çfarë nënkupton marrëdhënia sipas kësaj konvente:

- qëndrimi i fëmijës për një periudhë të caktuar kohe me ose në takim me prindërit ose persona të tjerë të ndryshëm nga prindërit, me të cilin ai ose ajo nuk banon zakonisht;
- çdo formë komunikimi ndërmjet fëmijës dhe një personi të tillë;
- dhënia e informacionit një personi të tillë për fëmijën ose fëmijët mbi këtë person.

Kjo konventë përcakton se në marrjen e vendimeve, parësore është mendimi i fëmijës dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës (5).

**Konventa e Këshillit të Evropës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”** përcakton:

- Njohja e mëmësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës.
- Njohja e atësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese mund të provohet ose përcaktohet nga njohja vullnetare ose me vendim gjykate.
- Njohja vullnetare e atësisë nuk mund të kundërshtohet ose të kontestohet për aq sa parashikon ligji i brendshëm për këto procedura, përveç kur personi që kërkon të njohë ose që ka njohur fëmijën nuk është babai biologjik.

Gjithashtu, Konventa përcakton se babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martese kanë të njëjtin detyrim për t'u kujdesur për fëmijën sikur të ishte lindur në martesë. Kur detyrimi ligjor për t'u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë, bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim zbatohet gjithashtu edhe në interes të fëmijës së lindur jashtë martese (6).

Vlerësimi i marrëdhënies së punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me hallkat e tjera kryesore të sistemit të referimit

**Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”** synon marrjen e masave mbrojtëse për të siguruar që birësimet jashtë vendit, të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare si dhe krijimin e një sistemi bashkëpunimi midis shteteve kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve. Gjithashtu, ai synon të sigurohet njohja në shtetet kontraktuese e birësimeve të bëra në përputhje me këtë Konventë. Në nenin 7 theksohet se autoritetet qendrore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në shtetet e tyre, për të mbrojtur fëmijët dhe për të arritur objektivat e tjera të Konventë (7).

Nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijëve, **Konventa e Evropës “Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”**, ka efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve nëpërmjet marrjes së masave konkrete në favor të tyre. Qëllimi i kësaj konvente është që të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese që në favor të mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijëve, të marrin masa për të promovuar të drejtat e tyre, t’u japin atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojnë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor. Dispozitat e saj paraqesin masat procedurale për të promovuar ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, si të drejtat procedurale të fëmijëve (8).

**Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosur** ka efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së fëmijëve nga rekrutimi nëpërmjet forcës ose detyrimit të tyre për t’u përdorur në konflikte të armatosura, nëpërmjet detyrimit të shteteve palë të marrin masa për të siguruar që anëtarët e forcave të armatosura të kenë mbushur moshën 18 vjeç (9).

**Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë** ka gjithashtu efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së fëmijëve nga shitja, prostitucioni dhe pornografia me ta, duke detyruar shtetet palë të marrin masa konkrete për mbrojtjen e tyre. Për të arritur më tej qëllimet e Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimin e dispozitave të saj, Protokolli shërben si një instrument për zgjerimin e mëtejshëm të masave që shtetet palë të Konventës duhet të ndërmarrin për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve (10).

**Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Moshën Minimale**, thekson moshën minimale nën 18 vjeç për t’u pranuar në çdo lloj punësimi, për vetë faktin se punësimi para kësaj moshe ka mundësi të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e të rinjve. Kjo pikë vendos dhe një herë në dukje mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Llojet e punësimit përcaktohen nga ligjet dhe rregullat e brendshme ose nga autoriteti kompetent, të cilët mund të autorizojnë punësimin ose pranimin në punë që në moshën 16 vjeç, me kusht mbrojtjen dhe kualifikimin e plotë të tij (11).

**Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”** siguron ofrimin e shërbimeve dhe asistencës së duhur për personat e identifikuar si të tillë. Parashikohen standarde garantuese në lidhje me identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijës së pashoqëruar, si: përfaqësimi i fëmijës së pashoqëruar nga një kujdestar ligjor, organizatë apo autoritet, i cili duhet të veprojë në interesin më të lartë të fëmijës (12).

**KUADRI LIGJOR SHQIPTAR, STRATEGJITË DHE MËNYRAT E NDËRHYRJES**

Qeveria shqiptare, duke u nisur dhe nga instrumentet ndërkombëtarë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ka hartuar një kuadër ligjor dhe institucional në mbrojtje të interesit më të lartë të të miturit.

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** është ligji më i lartë dhe themelor i një vendi dhe instrumenti kryesor mbi të cilin realizohet qeverisja e vendit. Ajo ndër të tjera ka sanksionuar: Jeta e personit mbrohet me ligj. Kushtetuta e Shqipërisë e cilëson të miturin subjekt të një mbrojtjeje të veçantë. Duke u udhëhequr nga interesi më i lartë i të miturit, theksohet se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Nga kjo dispozitë kushtetuese del qartë konsiderimi i fëmijës si subjekt i mbrojtjes së posaçme, në të cilën me një status të cilësuar, vjen mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, kurse shfrytëzimi është lidhur kryesisht me qëllimin për punë. Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi për punë parashikohet edhe në një tjetër dispozitë të përgjithshme të Kushtetutës, përkatësisht në nenin 26 të saj, e cila sanksionon të drejtën e individit për të mos kryer punë të detyruar (13).

Miratimi i këtij ligji **Nr. 10347, për “Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”** shënon një arritje të rëndësishme në përcaktimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes një kuadri të plotë ligjor dhe institucional në përputhje me Kushtetutën Shqiptare dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës. Ai vendosi themelin për ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë që do të garantojnë dhe sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja dhe shteti, si dhe theksoi përkujdesjen e posaçme për fëmijën. Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasjeje të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës. Ky ligj përmirëson ndjeshëm sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri, duke siguruar bashkëpunimin ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

Gjithashtu, në këtë ligj parashikohet si detyrim ligjor bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, duke e rregulluar këtë marrëdhënie nëpërmjet rregullave që do të përcaktojnë Këshilli i Ministrave.

Ky ligj përcakton dhe mekanizmat institucionalë që do të ngarkohen për realizimin e qëllimit të këtij ligji, dhe pikërisht në nenin 32 të tij përcaktohet: “Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, të cilat në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

**1. Mekanizmat në nivel qendror janë:**

- a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.** Ai koordinon dhe përcakton politikat që duhen ndjekur për fëmijët dhe monitoron zbatimin e strategjisë kombëtare për të drejtat e fëmijës.
- b) Ministri,** që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.
- c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.** Agjencia është institucion ekzekutiv, në varësi të ministrit që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ai ndjek zbatimin e këtij plan veprimi nga institucionet përgjegjëse në nivel

Vlerësimi i marrëdhënies së punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me hallkat e tjera kryesore të sistemit të referimit

qendror dhe vendor, harton raportet e progresit, orienton dhe mbështet donatorët vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të Planit të Veprimit për Fëmijë dhe organizon studime dhe analiza mbi gjendjen e fëmijëve në Shqipëri.

## 2. Mekanizmat në nivel vendor janë:

a) Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut;

b) Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë.

Këta dy mekanizma plotësojnë kuadrin institucional që ligji synon të krijojë me qëllim zbatimin efektiv të tij. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke filluar nga terreni, nga baza, e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit.

Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ata bashkëpunojnë edhe me organizatat jofitimprurëse për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Ky ligj përcakton detyrat e këtyre mekanizmave, si: bashkëpunimi me strukturat shtetërore përgjegjëse, mbështetje teknike e organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, koordinimin e funksionimit të grupit multidisiplinor me qëllim identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve. Në këtë ligj theksohet se në njësinë për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë duhet të ketë të paktën një punonjës me formim në fushën e punës sociale.

Duke u bazuar në detyrat e NJMF-ve, theksojmë se ato vlerësojnë dhe monitorojnë, identifikojnë dhe bashkërendojnë në mënyrë multidisiplinore mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve. Sensibilizojnë komunitetin, bashkëpunojnë me administratorët dhe me aktorët e tjerë, shërbejnë si qendër informacioni për komunitetin apo referojnë te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave të paraqitura, gjithashtu ato raportojnë periodikisht tek Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Pjesë e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve janë dhe organizatat jofitimprurëse, ku sipas legjislacionit në fuqi angazhohen të mbështesin:

- njësitë për mbrojtjen e fëmijëve/njësitë për të drejtat e fëmijëve, duke ndarë me institucionet shtetërore në nivel vendor praktikatat më të mira;
- marrin pjesë aktivisht në diskutimet dhe konsultimet për standardet, politikat, legjislacionin dhe kontribuojnë në vlerësimet mbi nevojat sociale të komuniteteve;
- ndihmojnë në ngritjen e shërbimeve komunitare alternative për grupet në nevojë dhe marrin pjesë aktivisht në grupet multidisiplinore;
- ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve;
- informojnë në mënyrë periodike Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; hartojnë kode të sjelljes dhe rregullore mbi procedurat për mbrojtjen e fëmijëve (14).

**Kodi i familjes (2003)**, që në fillim të tij, thekson se prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtaritë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës. Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga brenda martesë ose jashtë saj.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë

e familjes. Kodi i familjes mbështet idenë se fëmija, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi. Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore (15).

**Plani Veprimi për Fëmijët 2012-2015** synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm qeveritarë, donatorëve, shoqërisë civile dhe komunitetit, për të marrë vendime të orientuara drejt respektimit të të drejtave të fëmijëve. Me qëllim arritjen e “një mjedisi të sigurt për fëmijët”, ai nënvizon në mënyrë sistematike domosdoshmërinë e koordinimit dhe harmonizimit të politikave ndërsektoriale, me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre në funksion të një garantimi të plotë të të drejtave të fëmijëve. Ai tërheq vëmendjen në forcimin e strukturave institucionale dhe në nxitjen e hartimit të politikave gjithëpërfshirëse lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015, nënvizon domosdoshmërinë e një vëmendjeje të veçantë mbi nevojat e fëmijëve në programin e ndihmës ekonomike, me qëllim që ky program të ndikojë në zbutjen e varfërisë dhe parandalimin e fenomeneve sociale negative që rrisin përjashtimin e fëmijëve të varfër. Në këtë plan janë parashikuar masa konkrete për programin e ndihmës ekonomike, duke patur për qëllim që të merren në konsideratë nevojat e fëmijëve dhe kushtëzimin me përmbushjen e këtyre nevojave nga familjet përfituese (16).

**VKM nr. 263 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për bashkëpunimin ndërmjet mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”** parashikon se për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ngushtësisht me organizatat jofitimprurëse të cilat kanë në objekt të veprimtarisë së tyre të drejtat e fëmijëve. Bashkëpunimi ka në themel parimet e përgjithshme të interesit më të lartë të fëmijës, barazisë dhe mosdiskriminimit për shkaqet që janë të përcaktuara në ligj dhe ai duhet të realizohet ndërmjet mekanizmave institucionalë, siç i përcaktojmë, janë qendrorë, vendorë dhe organizatave jofitimprurëse. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit legjislativ në nivel qendror dhe në nivel vendor është faktor thelbësor në fuqizimin e institucioneve që monitorojmë dhe koordinojnë politikat publike të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (17).

**VKM nr. 265 për “Krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”** bën të mundur përcaktimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, i cili përbëhet nga:

- a. **Komiteti Drejtues**, ku një ndër detyrat e tij është: Miratimi në parim i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore apo personave juridikë privatë për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr 10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”;
- b. **Grupi Teknik Multidisiplinor**, është një grup *ad hoc* i cili funksionon pranë bashkisë/komunës;
- c. **Njësia për të Drejtat e Fëmijës** në nivel qarku;
- d. **Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës** në nivel bashkie/komune.

Duke iu referuar procedurës për ndërhyrje në ndihmë të fëmijëve në rrezik, vihet re se referimi



Vlerësimi i marrëdhënies së punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me hallkat e tjera kryesore të sistemit të referimit

në Njësine për Mbrojtjen e Fëmijës për një vlerësim nëse fëmija është në rrezik, bëhet nga vetë fëmija, prindi ose kujdestari ligjor, apo nga çdo person që vihet në dijeni të shkeljes së të drejtës, nga çdo person tjetër që ka lidhje farefisnore me fëmijën, çdo person fizik që vihet në dijeni lidhur me shkeljen e një të drejte të fëmijës apo nga një subjekt anonim. Çdo fëmijë që gjendet në situatë emergjente merret në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e policisë në bashkëpunim me Njësine për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Shërbimin Social Shtetëror, në çdo moment, qoftë brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës. Fëmijës në situatë emergjente i ofrohet në mënyrë të menjëhershme strehim, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mbështetje ligjore. Pas dhënies së ndihmës së menjëhershme, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës vendos mbledhjen e anëtarëve të Grupit Teknik Multidisiplinor, që janë më të nevojshëm për trajtimin e menjëhershëm të fëmijës, brenda 48 orëve nga konstatimi i faktit (18).

**VKM nr. 266 për “Bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”** përcakton bashkëpunimin midis strukturave të ASHMDF me NJDF në nivel qarku dhe NJMF në nivel bashkie/komune me qëllim garantimin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet monitorimit të zbatimit të detyrave të këtyre strukturave, rritjes së kapaciteteve të njësive dhe realizimin e ndërhyrjeve efektive në bashkëpunim me aktorët lokalë, rritjes së kapaciteteve të punonjësve, orientimit të OJF-ve për mbështetjen e këtyre njësive.

Gjithashtu, në këtë vendim përcaktohet bashkëpunimi midis strukturave të ministrive përgjegjëse në nivel vendor me NJDF dhe NJMF në lidhje me identifikimin e problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, juridike, marrjes pjesë në takimet e grupeve multidisiplinore, kryerjes së trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës, kryerjes së studimeve dhe projekteve të përbashkëta që synojnë evidentimin dhe/ose përmirësimin e gjendjes, shkëmbimit të informacionit, të dhënave statistikore (19).

**Ligji për nr. 9695 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”** përcakton procedurat e birësimit, si dhe organizimin, funksionimin e detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit. Ai ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet vendosjes së përhershme në një familje birësuese, marrjen e masave që birësimet, vendase dhe ndërvendase, të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, i cili është mbizotërues ndaj çdo interesi tjetër, krijimin e një sistemi bashkëpunimi, brenda dhe jashtë vendit, për marrjen dhe respektimin e masave mbrojtëse që parandalojnë dështimin e birësimit, rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve, sigurimin e bashkëpunimit me autoritetet vendore, autoritetet qendrore të vendeve të tjera apo organizatave të miratuara prej tyre, për mbarëvajtjen e periudhës pasbirësuese (20).

**Në Ligjin nr. 9669 “Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar)** theksohet garantimi i mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, përcaktohet se në rastet e rrezikut të mësipërm, gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës (21).

**Udhëzim nr. 10 “Mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”** ka si qëllim përcaktimin e detyrave, përgjegjësive dhe procedurave standarde për

institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Udhëzimi përmban procedura që duhet të ndiqen për të ndihmuar fëmijët të cilët kanë nevojë për t'u mbrojtur dhe është në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Ai thekson faktin që familja është mjedisi më i mirë ku duhet të rriten fëmijët dhe se ajo ka përgjegjësinë për t'i rritur dhe mbrojtur ata. Në këtë udhëzim prindërit dhe fëmija vlerësohen si aktorët dhe partnerët më të rëndësishëm për të përmirësuar situatën. Megjithatë, në rastet kur vërtetohet se familja nuk e mbron fëmijën, apo në rastin më të keq, është abuzuesi i fëmijës, strukturat shtetërore do të kenë përgjegjësinë për të ndërhyrë edhe në familje (22).

**VKM nr. 573 për “Miratimi i standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve”** shënon një hap të rëndësishëm në garantimin dhe zhvillimin e standardeve për shërbimet e njësive të mbrojtjes së fëmijëve duke garantuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në respektim të të drejtave të tyre. Zbatimi i standardeve ndikon në rritjen e kapitalit social, i cili në këndvështrimin praktik ka të bëjë me zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe të burimeve shoqërore, që përfshijnë institucionet, marrëdhëniet dhe normat që formojnë sasinë dhe cilësinë e ndërveprimeve shoqërore në një shoqëri. Gjithashtu, ato do të shërbejnë si dokument bazë për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për të vlerësuar kapacitetet e autoriteteve vendore për funksionimin e NJMF; për strukturat e Inspektoratit të Punës dhe të Shërbimit Social, të cilat do të kontrollojnë cilësinë e shërbimeve; për autoritetet vendore për të vlerësuar shërbimin e NJMF, për organizatat që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve, për autoritetet në nivel qendror, për institucionet akademike dhe organizatat e përfshira në veprimtari arsimore e trajnuese apo studiuesit e fushës, për vetëvlerësimin e punës nga NJMF-të, si dhe për raportimin tek Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Krahas kësaj, standardet mund të përdoren për të krijuar njësi matëse për praktikën dhe për të identifikuar fushat ku ka nevojë për përmirësim, si për advokacinë, ashtu edhe për nxitjen e përmirësimit të shërbimeve. Kjo bën që standardet të jenë të dobishme për të zhvilluar edhe më tej praktikën (23).

## KONKLUZIONE

Legjislacioni shqiptar ka evoluar ndjeshëm, duke krijuar një kuadër të plotë ligjor dhe institucional i cili synon ngritjen, funksionimin dhe standardizimin e sistemit gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre. Duke u udhëhequr nga interesi më i lartë i fëmijëve, përpjekjet e shtetit shqiptar për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional mbeten të vazhdueshme.

Aktualisht, është arritur ngritja e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë që garantojnë dhe sigurojnë respektimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës. Gjithashtu, është mirëpërcaktuar rëndësia dhe detyrimi ligjor i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës së institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, vendor dhe organizatave jofitimprurëse që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, marrëdhënie kjo e rregulluar nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhënia mes aktorëve është një element kyç, sepse vetëm duke ndarë, bashkëpunuar, koordinuar dhe harmonizuar përpjekjet e tyre, ato mund të arrijnë të plotësojnë përpjekjet e njëri-tjetrit.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve është faktor thelbësor në fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Legjislacioni shqiptar ka nxjerrë udhëzime ku përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat standarde për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse, të cilat ofrojnë shërbimet lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

Miratimi i ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe një sërë

Vlerësimi i marrëdhënies së punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve me hallkat e tjera kryesore të sistemit të referimit

aktesh të tjera në zbatim të tij, Protokollit të Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve, Udhëzim nr. 10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 573 datë 24.06.2015 “Miratimi i standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve” garantojnë dhe zhvillojnë më tej të drejtat e fëmijëve dhe përmirësojnë dukshme legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve.

Hartimi dhe implementimi i paketës së standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve shënoi një hap të rëndësishëm dhe vendimtar në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të unifikuara ndërmjet NJMF.

Megjithatë, mbetet për t’u theksuar se përcaktimi në legjislacion i vendosjes së një punonjësi social për njësi në strukturën e njësive bashkiake, tregon se ekzistojnë kufizime në burime njerëzore për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu, njësi bashkiake të ndryshme kanë kapacitete (në numër fëmijësh) dhe larmi problematikash të ndryshme, kështu që vlen të gjykohet dhe përcaktohet jo vetëm zona e mbulimit të një punonjësi social, por edhe kapacitetet në punën e tij. Nga ana tjetër, duke parë së në çdo burim legjislacioni “për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” theksohej mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, atëherë kërkohet një mirëfunksionim më i drejtë i të gjitha hallkave institucionale, si ato menaxheriale, buxhetore, burime njerëzore, qofshin këto publike dhe private, duke implementuar të gjithë strukturën nga ana praktike, për t’u njohur më mirë me problematikat, dhe jo vetëm.

Me gjithë rëndësinë, përmirësimin dhe plotësimin e legjislacionit që ka arritur sot shteti dhe shoqëria shqiptare ndaj mbrojtjes së fëmijëve, mbetet për t’u theksuar se ai duhet të jetë një proces në vazhdim dhe thellim, duke i prekur, trajtuar dhe vënë në zbatim më konkretisht politikat që ndërmerren për ta. Kjo realizohet vetëm nëpërmjet frymës së bashkëpunimit, implementimit, dhe tolerancës së të gjitha hallkave institucionale.

## REFERENCAT

- 1- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga OKB, më 20 nëntor 1989. Fq. 2-8. [https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC\\_albanian\\_language\\_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)
- 2- Lita. Z. Forcimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve, të Rinjve dhe Familjes në Shqipëri. UNICEF, 2007. Fq. 23.
- 3- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, dekreti nr. 1573, datë 2.8.1996. Fq. 7. [http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)
- 4- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996. FZ. 20-1996, fq. 44. [http://www.pp.gov.al/web/ligji\\_ratifikues\\_i\\_kednj\\_790.pdf](http://www.pp.gov.al/web/ligji_ratifikues_i_kednj_790.pdf)
- 5- Konventa Europiane mbi marrëdhëniet me fëmijët, ratifikuar më ligjin nr.9359, datë 24.03.2005. Fq. 2-3. <http://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/Konventa-Europiane-per-marredheniet-me-femijet1.pdf>
- 6- Konventa e Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës” ratifikuar më 25.05.2011. Fq. 1-2. [http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Ratifikimin%20i%20Konventes%20se%20femijeve%20lindur%20jashte%20martese%20\(2011\).pdf](http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Ratifikimin%20i%20Konventes%20se%20femijeve%20lindur%20jashte%20martese%20(2011).pdf)
- 7- Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15.6.2000. Fq. 1-3. <http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Konventa%20mbi%20biresimet%20ndershtetore.pdf>

- 8- Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”. Datë 1996. <http://www.infocip.org/al/?p=3261>
- 9- Protokoll opsional i konventës për të drejtat e fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, ratifikuar me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007. Fq. 2. [http://www.sociale.gov.al/files/userfiles/Legjislacioni/Protokolli-opsional-i-Konventes-Per-te-drejtat-e-femijeve-ne-lidhje-me-perperfshirjen\\_e\\_femijeve\\_ne-konflikte\\_te\\_armatosura.pdf](http://www.sociale.gov.al/files/userfiles/Legjislacioni/Protokolli-opsional-i-Konventes-Per-te-drejtat-e-femijeve-ne-lidhje-me-perperfshirjen_e_femijeve_ne-konflikte_te_armatosura.pdf)
- 10- Protokoll opsional i konventës për të drejtat e fëmijëve në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, ratifikuar me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007. FZ. 83-2010, fq. 4309. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2010/PDF-2010/83-2010.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2010/PDF-2010/83-2010.pdf)
- 11- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Moshën Minimale, 1973, ratifikuar me ligjin 8086, datë 13.3.1996. FZ. 179-2015, fq. 12177. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/179-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/179-2015.pdf)
- 12- Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008. Fq. 5. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016805d3f2f>
- 13- Ligji nr. 8417 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), datë 21.10.1998. Fq. 2-15. <http://www.shish.gov.al/files/Ligjet/KUSHTETUTA%20E%20RSH.pdf>
- 14- Ligjin Nr. 10347 për “Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, datë 04.11.2010. Fq. 2-17. <http://www.vendime.al/ligj-nr-10-347-date-4-11-2010-per-mbrojtjen-e-te-drejtave-te-femijes/>
- 15- Ligji nr 9062, “Kodi i Familjes”, datë 8.5.2003. Fq. 9-73. [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_i\\_familjes\\_22.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_familjes_22.pdf)
- 16- VKM nr. 182 për “Miratimin e planit të veprimit për fëmijë, 2012-2015” , datë 13.3.2012. Fq. 13-15. <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/94335/110697/F-1773935771/ALB-94335.pdf>
- 17- VKM nr. 263 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për bashkëpunimin ndërmjet mekanizmave institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizmin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, datë 12.4.2012. FZ. 56-2012, fq. 2821-2822. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf)
- 18- VKM nr. 265 “Krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”, datë 12.04.2012. FZ. 56-2012, fq. 2826-2830. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf)
- 19- VKM nr. 266 “Bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, datë 12.04.2012. FZ. 56-2012, fq. 2831-2832. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/56-2012.pdf)
- 20- Ligji nr. 9695 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, datë 19.3.2007. Fq.1. <http://www.qbz.gov.al/ligje.pdf/biresimi/ligji%20per%20biresimin.pdf>
- 21- Ligji nr. 9669 për “Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar), datë 18.12.2006. Fq. 3. <http://www.osce.org/sq/albania/30437?download=true>
- 22- Udhëzim nr. 10 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve ne rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”, datë 25.2.2015. FZ. 33-2015, fq. 1473. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/33-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/33-2015.pdf)
- 23- VKM nr. 573 “Miratimi i standardeve të shërbimeve të NJMF”, datë 24.06.2015. FZ. 116-2016, fq. 6071-6093. [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/116-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/116-2015.pdf)





**SHKENCAT  
E APLIKUARA  
DHE  
EKONOMIKE**

**SEKSIONI 3**

